



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a.

Përgjigje ndaj Raportit Konsultativ të ZRRE-së: “Kriteret për Matjen e Konkurrencës Efektive në Furnizimin me Energji Elektrike”

Dorëzuar më 16 mars 2011

I. Hyrje

Këto janë komentet e KEK-ut lidhur me çështjet e ZRRE-së, të cilat janë ngritur në Raportin Konsultativ (RK), lëshuar nga ZRRE-ja më 16 mars 2011. KEK-u falënderon ZRRE-në për adresimin e kësaj çështje të rëndësishme dhe do të dëshironte të jepte mendimin e tij mbi këtë çështje të ngritur dhe propozimet që janë dhënë. KEK-u pajtohet me qasjen e përgjithshme. Si Furnizuesi Publik dhe operatori i vetëm në tregjet e shitjes me shumicë dhe me pakicë në Kosovë, KEK-u e ndjen se mund të japë një pikëvështrim të vlefshëm lidhur me çështjet e ngritura nga aspekti afarist dhe operativ.

II. Definicioni i Tregut.

Në RK, ZRRE-ja fokusohet në anën e “Tregut” të shitjes me pakicë për të përcaktuar nivelin e konkurrencës në furnizim. KEK-u sugjeron se ZRRE-ja po ashtu ka marrë në konsideratë edhe anën e tregut “me shumicë” në matjen e nivelit të konkurrencës. Duke ditur që aktualisht ekziston një burim i rëndësishëm i gjenerimit vendor dhe që në fakt të gjithë gjeneratorët e tjerë (hidro, energjia e erës etj) shesin 100% të prodhimit të tyre tek Furnizuesi Publik, mundë të konkludohet se tregu vendor i shitjes me shumicë nuk është konkurrues. Kjo situatë nuk pritët të ndryshojë dukshëm në një të ardhme të afërt kur kemi parasysh ristrukturimin dhe privatizimin. Konkurrenca e tregut të shitjes me shumicë ndikon drejtpërdrejt në konkurrencën e tregut me pakicë.

Në Seksionin 2 të RK-së, ZRRE-ja përmend shkurtimisht që:

Tregu përkatës është furnizimi vjetor për të parandaluar ndërrimin e shpeshtë nga ana e konsumatorëve dhe për të përfituar në kohën e shfrytëzimit

KEK-u pajtohet që në një perspektivë vjetore është e mirë dhe e mbështet pozicionin e ZRRE-së që ndërrimi i shpeshtë nga ana e konsumatorëve të mëdhenj nuk është në interes të publikut, meqë kjo mund të rezultojë në praktikë jo të drejtë të tregut. Konsumatorët e mëdhenj në përgjithësi kërkojnë shërbim cilësor dhe të pandërprerë, gjë që shton vlerën e operimeve të tyre. KEK-u, si Furnizues Publik, mund të ofrojë vetëm këtë nivel të shërbimit (tjetër prej atij gjatë situatës emergjente) të konsumatorët e mëdhenj të kësaj tension të lartë dhe të mesëm nëse KEK-u mund të planifikojë furnizimin e tij të përgjithshëm (blerjet nga gjeneratorët dhe importet) për një periudhë vjetore. Angazhimet duhet të bëhen paraprakisht deri në një vit për të pasur furnizim të qëndrueshëm në çmim të arsyeshëm. Si kthim për angazhimet e marra nga ana e Furnizuesit Publik, Konsumatorët e Privilegjuar duhet të angazhohen në kontrata të arsyeshme me kohëzgjatje një vit. Nëse kjo nuk ndodh, Furnizuesi Publik do të ballafaqohet me kosto që dalin nga të gjithë konsumatorët e tjerë, kjo situatë nuk është në interes publik.

KEK-u është i vetëdijshëm që Neni 19.2 i Ligjit për Energji Elektrike shtjellon kriteret e ndërrimit për Konsumatorët e Privilegjuar. Ne mendojmë se ky nen është presupozuar për shërbimin të Konsumatorët e Privilegjuar në një mjedis konkurrues të tregut. Neni 18. është shumë relevant për këtë situatë dhe ai nënkupton këtë në vijim:

6. Furnizuesi Publik do të:

6.2. furnizojë me energji elektrike konsumatorët e privilegjuarduke iu nënshtruar kushteve të tjera, ashtu siç përcakton Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Duke ditur që ZRRE-së i është dhënë autoriteti për të përcaktuar kushtet e furnizimit për Konsumatorët e Privilegjuar, të cilët e marrin shërbimin nga Furnizuesi Publik, ajo ka të drejtën e aprovimit të kushteve, siç janë kohëzgjatja e kontratës, sipas të cilës ofrohet shërbimi. Kjo është e rëndësishme veçanërisht duke marrë parasysh çështjet e konkurrencës të ngritura në këtë RK.

III. Kriteret e Vlerësimit të Konkurrencës

Në adresimin e kriterëve të vlerësimit, ZRRE-ja ka paraqitur një term të ri në Kosovë "Furnizues i Pavarur", për çdokë që ofron furnizim me pakicë përveç Furnizuesit Publik. Do të ishte mirë që të sigurohet definicioni zyrtar i këtij termi, i cili përdoret më shpesh në tregjet e tjera.

Dy kriteret e propozuara të vlerësimit të konkurrencës:

- Numri i Furnizuesve të Pavarur dhe
- Ndarja e Tregut në të cilat shërbejnë Furnizuesit e Pavarur

duken të arsyeshme dhe pikat kryesore të propozuara, tre ose më shumë Furnizues të Pavarur dhe ndarja e tregut në të cilat shërbejnë Furnizuesit e Pavarur për më shumë se 30%, po ashtu duken të arsyeshme.

Në përcaktimin e konkurrencës së tregut të shitjes me pakicë, veçanërisht atë që ka të bëjë me Furnizuesin e Pavarur kundrejt Furnizuesit Publik, KEK-u inkurajon ZRRE-në që të marrë në konsiderat situatën e çmimeve në treg. Furnizuesi Publik aktualisht kërkohet që të furnizojë konsumatorët e Amvisërisë me tarifa më të ulëta se kostoja e furnizimit përderisa tarifat për kategoria jo të amvisërisë (kategorit industriale dhe komerciale) vendosen për të mbuluar më shumë se koston, ashtu siç përcaktohet me nivelet e përgjithshme të koston të vendosura nga ZRRE-ja. Kjo situatë është shumë dëmtoese në një treg konkurrues. Një joblancim i tillë krijon një situatë artificiale që Furnizuesit e Pavarur ta shfrytëzojnë këtë. Nëse furnizuesit e tillë shërbejnë konsumatorët profitabil të Furnizuesit Publik, atëherë do të mbetën vetëm disa shfrytëzues të tensionit të mesëm dhe shfrytëzuesit e mëdhenj të tensionit të ulët në mënyrë që të sigurohet subvencion për amvisëri. Situata e tillë nuk është në interes të publikut dhe ZRRE-ja inkurajohet që të racionalizojë tarifat ashtu që ato të jenë kosto efektive për të gjitha klasat e konsumatorëve. KEK-u e pranon se kjo nuk mund të bëhet e gjitha përnjëherë prandaj, e inkurajon ZRRE-në që të nisë gradualisht tarifat kosto reflektive që janë në fuqi në vendimin aktual të rishikimit tarifor para 1 prillit 2011.

IV. Procedurat e Vlerësimit

KEK-u mbështet dispozitat për vlerësimin e tregut të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Ashtu siç theksohet në RK, KEK kërkon nga ZRRE-ja që të ndërmerr vlerësimin menjëherë. Kjo është shumë kritike përderisa KEK-u kërkon aprovimin e tarifave të rregulluara për shërbimin 220KV, në mënyrë që të furnizojë me energji këtë konsumator në rolin e Furnizuesit Publik, pas prillit 2011. ZRRE-ja po ashtu inkurajohet që të shfrytëzojë lirinë e saj të veprimit, ashtu siç diskutohet në seksionin II. më sipër, për të aprovuar kushtet e shërbimit, duke përfshirë kohëzgjatjen një vjeçare të specifikuar në draft Marrëveshjen për Furnizim me Energji Elektrike, që sigurohet në raport me këtë konsumator .